Të dhënat tregojnë një shtrirje të gjerë institucionale të PKZHUV 2026**,** me 26 projekte aktive të zhvilluara në të katër fakultetet, qendrat kërkimore-shkencore dhe Qendrën e Zhvillimit Rajonal. Krahas numrit të projekteve, evidentohet diversifikimi tematik dhe prania e projekteve me karakter të aplikuar, ndërdisiplinor dhe të lidhur me problematika konkrete të Universitetit dhe rajonit të Vlorës. Kjo përputhet me orientimin e UV-së drejt kërkimit të aplikuar, inovacionit dhe forcimit të kapaciteteve kërkimore, të parashikuar në kuadrin strategjik të UV-së.

7.2. PROJEKTET ME FINANCIM KOMBËTAR

Gjatë periudhës janar-shtator 2026, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vijuar zbatimin e projekteve kërkimore me financim kombëtar, të mbështetura nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) në kuadër të Programit Kombëtar të Kërkim-Zhvillimit (PKKZH)**.**

Në portofolin e projekteve me financim kombëtar evidentohen **8 projekte në zbatim**, të shpërndara në Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe Fakultetin e Shkencave Humane. Projektet mbulojnë fusha të ndryshme të kërkimit, përfshirë financat dhe përfshirjen financiare digjitale, mjedisin dhe ekosistemet detare, ndryshimet

klimatike dhe edukimin, ekonominë e gjelbër dhe blu, monitorimin e cilësisë së ujit, teknologjitë digjitale dhe gjuhët e huaja, ndërgjegjësimin mjedisor dhe transformimin digjital në turizëm.

NR.	TITULLI I PROJEKTIT	PROGRAMI I FINANCIMIT	DREJTUESI	NJËSIA ZBATUESE	STATUSI
1	ALDFIN – Përfshirja Financiare Dixhitale në Qarkun e Vlorës	PKKZH 2026 (AKKSHI)	Prof. Asoc. Dr. Migena Petanaj	Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit (FE)	Në vazhdim
2	Biomonitorimi i integruar i ekosistemit detar – Gjiri i Vlorës	PKKZH 2026 (AKKSHI)	Prof. Asoc. Denada Sota	Departamenti i Biologjisë (FSHTN)	Në vazhdim
3	KLIMEDU-AL – Klima dhe Edukimi në Arsimin e Lartë Shqiptar	PKKZH 2026 (AKKSHI)	Prof. Asoc. PhD. Esmeralda Laçi	Departamenti i Edukimit (FSHH)	Në vazhdim
4	Ekonomia e Gjelbër dhe Blu në Shqipëri	PKKZH 2026 (AKKSHI)	Dr. Emi Malaj	Departamenti i Ekonomiksit (FE)	Në vazhdim
5	BlueGuard - Modelimi inteligjent i cilësisë së ujit	PKKZH 2026 (AKKSHI)	Dr. Ilira Pulaj	Departamenti i Ekonomiksit (FE)	Në vazhdim
6	Teknologjia dixhitale në përkthimin e terminologjisë teknike	PKKZH 2026 (AKKSHI)	PhD. Irena Skëndo	Departamenti i Gjuhëve të Huaja (FSHH)	Në vazhdim
7	Ndërgjegjësimi mjedisor përmes përvojës personale dhe artikulimit gjuhësor	PKKZH 2026 (AKKSHI)	Dr. Eliona Naqo	Departamenti i Gjuhëve të Huaja (FSHH)	Në vazhdim

8	Transformimi digital në turizëm: Ndikimi i teknologjisë në konkurrueshmërinë e SMBV-ve në Qarkun e Vlorës, sfidat dhe mundësitë	Programi Kombëtar i Kërkim-Zhvillimit (AKKSHI)	Dr. Rezarta Hasanaj	QKSIT (FE)	Në vazhdim

Tabela nr. 8. Projektet me financim kombëtar në zbatim gjatë vitit 2026

Portofoli prej 8 projektesh me financim kombëtar tregon një pjesëmarrje të gjerë të njësive akademike dhe kërkimore të UV-së në programet e AKKSHI-së. Tematikat e projekteve evidentojnë orientimin drejt çështjeve me interes aktual dhe potencial aplikativ, veçanërisht në fushat e digjitalizimit, mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, ekonomisë së gjelbër dhe blu, teknologjisë, turizmit dhe edukimit. Shpërndarja e projekteve ndërmjet disa njësive akademike kontribuon gjithashtu në diversifikimin e portofolit kërkimor të Universitetit dhe në forcimin e kapaciteteve për tërheqjen e financimeve kombëtare.

7.3. PROJEKTET ME FINANCIM NDËRKOMBËTAR

Gjatë periudhës janar-shtator 2026, pjesëmarrja në programe dhe projekte me financim ndërkombëtar ka përbërë një nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së SKSHP-së. Sektori ka ndjekur paralelisht projektet në zbatim, projektet e reja të shpallura fituese dhe përgatitjen e projekt-propozimeve në kuadër të programeve të Bashkimit Evropian dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare.

Portofoli përfshin programe si Horizon Europe, Erasmus+, Interreg/IPA ADRION, si dhe iniciativa të tjera evropiane, duke reflektuar diversifikimin e burimeve të financimit dhe zgjerimin e pjesëmarrjes së UV-së në bashkëpunimin ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhe, janë përfunduar dhe dorëzuar 63 aplikime në kuadër të thirrjeve për financim ndërkombëtar.

Projekt-propozimet mbulojnë shëndetësinë dhe mirëqenien, inteligjencën artificiale dhe transformimin digjital, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë e gjelbër dhe blu, turizmin e qëndrueshëm, trashëgiminë kulturore, sipërmarrjen dhe modernizimin e arsimit të lartë. Kjo shtrirje tematike pasqyron përfshirjen e personelit akademik nga njësi të ndryshme të universitetit dhe orientimin drejt bashkëpunimit ndërdisiplinor, në përgjigje të prioriteteve institucionale dhe nevojave të zhvillimit rajonal.

SKSHP-ja ka mbështetur procesin përmes informimit mbi thirrjet, koordinimit me personelin akademik dhe partnerët, plotësimit të dokumentacionit institucional dhe ndjekjes së procedurave brenda afateve të përcaktuara. Vëmendje i është kushtuar identifikimit të partnerëve, përcaktimit të rolit të UV-së në konsorciume dhe bashkërendimit të kontributeve të njësive pjesëmarrëse në përgatitjen e projekt-propozimeve.

Krahas aplikimeve të reja, sektori ka vijuar mbështetjen administrative dhe koordinuese për projektet në zbatim, duke lehtësuar komunikimin ndërmjet ekipeve të projekteve, strukturave universitare dhe partnerëve ndërkombëtarë. Kjo veprimtari kontribuon në forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e projekteve dhe në krijimin e mundësive të qëndrueshme të bashkëpunimit në kërkim, inovacion dhe zhvillim akademik.

Shpërndarja e 63 aplikimeve sipas programeve dhe instrumenteve të financimit ndërkombëtar paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Programi / instrumenti i financimit	Numri i aplikimeve
1	Horizon Europe, përfshirë veprimet Marie Skłodowska-Curie	17
2	Erasmus+ dhe thirrje të evidentuara së bashku me Korpusin Evropian të Solidaritetit	37
3	EIT Higher Education Initiative	2
4	UNITWIN/UNESCO Chairs	1
5	Interreg IPA Greqi–Shqipëri	2
6	Instrumente dhe iniciativa të tjera ndërkombëtare[1]	4

Tabela nr. 9 Shpërndarja e aplikimeve ndërkombëtare sipas programeve të financimit, janar-shtator 2026

7.3.1. PROJEKTET NË ZBATIM

Gjatë periudhës janar–shtator 2026, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vijuar zbatimin e një portofoli projektesh që mbështesin kërkimin shkencor, zhvillimin akademik dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Sipas databazës së përditësuar, në fund të periudhës së raportimit evidentohen 23 projekte me status "në vazhdim", të zbatuara nga fakultetet, departamentet, qendrat kërkimore-shkencore dhe Qendra e Zhvillimit Rajonal.

Programet e financimit përfshijnë Horizon Europe, Erasmus+, Interreg IPA, CEEPUS dhe READ. Projektet mbulojnë fusha si shëndetësia, mjedisi dhe qëndrueshmëria, inteligjenca artificiale dhe transformimi digjital, turizmi, zhvillimi rajonal, arsimi dual, mikrokredencialet, mobiliteti, transporti dhe logjistika detare, të drejtat e fëmijëve dhe integrimi evropian.

Një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2026 është përfshirja në portofol e projekteve të reja të financuara, ndër të cilat TWIN4VLORA, CLIM-AL EU, ARCH dhe NURTURE. Në projektin TWIN4VLORA, të financuar nga Horizon Europe–WIDERA 2026, UV ka rolin e koordinatorit. Gjithashtu, Universiteti ka rol koordinues në projektin CLIM-AL EU, në kuadër të Jean Monnet Actions, ndërsa në projektet ARCH dhe NURTURE, të programit Erasmus+ Capacity Building in Higher Education, merr pjesë si partner. Portofoli evidenton edhe vijimësinë e projekteve të nisura në vitet e mëparshme, përfshirë ato në kuadër të Erasmus+ CBHE dhe Interreg IPA, si dhe tre projekte të programit READ - Cohorta IV, të drejtuara nga personeli akademik i UV-së. Ndjekja e këtyre projekteve kërkon bashkërendim të vazhdueshëm për realizimin e aktiviteteve, përmbushjen e detyrimeve të raportimit dhe dokumentimin e rezultateve, në përputhje me kërkesat e programeve përkatëse.

Tregues për projektet në vazhdim

TREGUESI	JANAR-SHTATOR 2026
PROJEKTE ME STATUS "NË VAZHDIM"	**23**
PROJEKTE KU UV KA ROL DREJTUES/KOORDINUES*	**të paktën 6**
PROJEKTE READ – COHORTA IV	**3**
PROGRAME KRYESORE FINANCIMI	Horizon Europe, Erasmus+, Interreg IPA, CEEPUS, READ

Tabela nr. 10. Treguesit për projektet në vazhdim gjatë vitit 2026

Numri prej **23 projektesh në vazhdim** evidenton zgjerimin e portofolit të projekteve të UV-së dhe një shpërndarje të gjerë të tyre ndërmjet njësive akademike dhe kërkimore. Veçanërisht pozitiv është forcimi i rolit të Universitetit nga pjesëmarrës në konsorciume drejt marrjes së roleve koordinuese dhe drejtuese, si dhe përfshirja në programe të ndryshme financimi që lidhin kërkimin shkencor me zhvillimin institucional, inovacionin dhe nevojat e territorit.

7.4. MONITORIMI DHE MBËSHTETJA E ZBATIMIT TË PROJEKTEVE

Gjatë periudhës janar–shtator 2026, SKSHP ka vijuar monitorimin dhe mbështetjen administrative të projekteve në zbatim në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, në bashkëpunim me koordinatorët e projekteve, njësitë zbatuese dhe strukturat administrative e financiare të Universitetit.

Veprimtaria e Sektorit është përqendruar në ndjekjen e ecurisë së projekteve, administrimin dhe përditësimin e dokumentacionit përkatës, koordinimin e komunikimit institucional, ndjekjen e afateve dhe detyrimeve kontraktuale, si dhe mbështetjen e procedurave që lidhen me raportimin, marrëveshjet e partneritetit, dokumentacionin financiar dhe procedurat e tjera të nevojshme gjatë ciklit të zbatimit të projekteve.

Gjatë vitit 2026 është vijuar gjithashtu koordinimi me partnerët ndërkombëtarë për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në projektet në zbatim. Në këtë kuadër përfshihen organizimi dhe pjesëmarrja në takime të konsorciumeve, aktivitete trajnuese, vizita studimore, takime të komiteteve drejtuese, aktivitete të komunikimit dhe diseminimit, si dhe përgatitja dhe përcjellja e materialeve dhe dokumentacionit të kërkuar nga partnerët drejtues.

Një shembull i kësaj veprimtarie është projekti **DUALBA**, në të cilin UV vijon angazhimin në zbatimin e aktiviteteve të projektit dhe në detyrat e komunikimit dhe diseminimit. Gjatë periudhës janë ndjekur aktivitetet e projektit, përgatitja e materialeve promocionale dhe raportuese, si dhe koordinimi për takimet dhe vizitat e konsorciumit.

Në kuadër të projekteve **Interreg**, janë ndjekur gjithashtu procedurat institucionale që lidhen me marrëveshjet e partneritetit, dokumentacionin për nënshkrim, koordinimin me partnerët dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin dhe zbatimin e projekteve. Në mënyrë të ngjashme, për projektet e financuara nga Erasmus+, Horizon Europe dhe programet e tjera është siguruar mbështetje sipas kërkesave specifike të secilit instrument financues.

Një element i rëndësishëm gjatë periudhës ka qenë edhe **përditësimi i vazhdueshëm i evidencës së projekteve dhe projekt-propozimeve**. Për secilin projekt janë evidentuar, sipas rastit, programi i financimit, roli i Universitetit, njësia zbatuese, koordinatori, periudha e zbatimit, financimi, detyrimi për bashkëfinancim dhe statusi i projektit. Kjo evidencë ka shërbyer edhe për raportimet institucionale mbi ecurinë e portofolit të projekteve.

Rritja e numrit dhe diversifikimi i projekteve në zbatim ka rritur njëkohësisht nevojën për monitorim të strukturuar dhe koordinim ndërmjet SKSHP-së, koordinatorëve akademikë dhe strukturave administrative e financiare. Përditësimi sistematik i databazës së projekteve dhe ndjekja e tyre përgjatë ciklit të zbatimit përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm për përmirësimin e monitorimit institucional, respektimin e detyrimeve kontraktuale dhe sigurimin e raportimit të saktë mbi portofolin e projekteve të UV-së.

8. BASHKËPUNIMI, RRJETËZIMI DHE NDËRKOMBËTARIZIMI I KËRKIMIT

Veprimtaria kërkimore dhe projektuale gjatë periudhës janar–shtator 2026 është shoqëruar me zgjerimin e bashkëpunimit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë me institucione të arsimit të lartë, qendra kërkimore dhe organizata partnere brenda dhe jashtë vendit.

Një pjesë e rëndësishme e këtij bashkëpunimi është zhvilluar përmes **konsorciumeve të projekteve ndërkombëtare**, ku personeli akademik i UV-së ka bashkëpunuar në hartimin e projekt-propozimeve, zbatimin e aktiviteteve të projekteve, shkëmbimin e ekspertizës, zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe krijimin e partneriteteve të reja.

Pjesëmarrja në programe si **Horizon Europe, Erasmus+, Interreg IPA dhe CEEPUS**, krahas bashkëpunimeve të zhvilluara në kuadër të projekteve dhe iniciativave të tjera, ka kontribuar në zgjerimin e rrjetit të partnerëve të UV-së dhe në forcimin e dimensionit ndërkombëtar të kërkimit shkencor.

Veçanërisht, marrja e roleve **drejtuese dhe koordinuese** në një pjesë të projekteve evidenton kalimin gradual nga pjesëmarrja kryesisht si partner drejt një angazhimi më aktiv të Universitetit në konceptimin dhe drejtimin e iniciativave ndërkombëtare. Ky zhvillim është në përputhje me objektivat institucionale për rritjen e ndërkombëtarizimit të kërkimit dhe integrimin më të gjerë të UV-së në hapësirën evropiane të kërkimit dhe arsimit të lartë.

Në funksion të rrjetëzimit, SKSHP ka mbështetur gjithashtu **identifikimin e partnerëve potencialë, shkëmbimin e dokumentacionit institucional dhe Partner Information Forms (PIF), komunikimin me universitete dhe organizata të interesuara për bashkëpunim, si dhe shpërndarjen e ftesave për partneritet te njësitë akademike**.

Zgjerimi i partneriteteve dhe pjesëmarrja në konsorciume ndërkombëtare krijojnë bazën jo vetëm për rritjen e numrit të aplikimeve, por edhe për zhvillimin e projekteve me përmbajtje

më të fortë kërkimore dhe ndërdisiplinore. Për këtë arsye, administrimi i një **databaze të strukturuar të partnerëve dhe bashkëpunimeve**, së bashku me zhvillimin e partneriteteve strategjike afatgjata, mbetet një nga drejtimet me rëndësi për rritjen e performancës së UV-së në kërkimin dhe projektet ndërkombëtare.

9. INFORMIMI DHE MBËSHTETJA E PERSONELIT AKADEMIK

Gjatë periudhës janar-shtator 2026, informimi dhe mbështetja e personelit akademik për mundësitë e financimit dhe pjesëmarrjen në projekte ka përbërë një nga drejtimet e vazhdueshme të veprimtarisë së SKSHP-së. Puna e Sektorit është orientuar si në **identifikimin dhe shpërndarjen e thirrjeve për financim**, ashtu edhe në **mbështetjen konkrete të personelit akademik gjatë fazave të përgatitjes dhe dorëzimit të projekt-propozimeve**.

Informimi është realizuar nëpërmjet komunikimit institucional me njësitë akademike, përgjegjësit e qendrave kërkimore, zëvendësdekanët përgjegjës për kërkimin shkencor dhe personelin akademik, si dhe përmes publikimit të mundësive të përzgjedhura në kanalet institucionale të Universitetit.

9.1. THIRRJET PËR PROJEKTE DHE MUNDËSITË E FINANCIMIT

Gjatë periudhës së raportimit, SKSHP ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme programe dhe burime financimi kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim identifikimin e thirrjeve me interes për Universitetin dhe njësitë e tij akademike.

Procesi ka përfshirë **identifikimin e thirrjeve, analizën paraprake të kushteve të pjesëmarrjes, afateve, fushave prioritare dhe kritereve të pranueshmërisë**, si dhe përcjelljen e informacionit te strukturat dhe personeli akademik potencialisht i interesuar.

Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2026 i është kushtuar mundësive të ofruara në kuadër të **Horizon Europe, Erasmus+, Interreg VI-A IPA Greece-Albania 2021-2027, CERV, Creative Europe, EIT Higher Education Initiative**, si dhe programeve dhe thirrjeve kombëtare, përfshirë **AKKSHI dhe READ**.

Për thirrjet e vlerësuara me interes institucional, informacioni është strukturuar duke evidentuar elementet kryesore të nevojshme për vendimmarrjen e personelit akademik: programin dhe thirrjen, objektivin, afatin e aplikimit, kategoritë e subjekteve të pranueshme,

buxhetin ose nivelin e financimit, kërkesat për partneritet dhe rolin e mundshëm të Universitetit.

Gjatë muajve gusht-shtator 2026, një vëmendje e posaçme iu kushtua **thirrjeve të 6-të dhe të 7-të për Projektet e Vogla të Programit Interreg VI-A IPA Greece–Albania 2021-2027**. Informacioni mbi ditën informuese dhe mundësitë e aplikimit iu përcoll strukturave kërkimore dhe akademike, duke krijuar më pas edhe interes konkret për përgatitjen e disa projekt-propozimeve.

Paralelisht, është vijuar puna për **publikimin e thirrjeve dhe mundësive të financimit në faqen zyrtare të Universitetit**, me synim krijimin e një burimi të qëndrueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm informacioni për personelin akademik.

Monitorimi dhe shpërndarja e strukturuar e thirrjeve ka ndihmuar në kalimin nga informimi i përgjithshëm drejt një qasjeje më të orientuar sipas profilit të njësive akademike dhe kushteve konkrete të programeve financuese. Ky proces krijon bazën për rritjen e numrit dhe cilësisë së aplikimeve dhe për një planifikim më të hershëm të pjesëmarrjes së UV-së në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.

9.2. ASISTENCA PËR APLIKIME DHE PROJEKT-PROPOZIME

Mbështetja e SKSHP-së nuk është kufizuar në shpërndarjen e informacionit mbi thirrjet, por ka vijuar me asistencë konkrete gjatë procesit të përgatitjes së aplikimeve.

Sipas nevojave të secilit projekt-propozim, mbështetja ka përfshirë interpretimin e kërkesave të thirrjes, komunikimin me aplikantët dhe partnerët, plotësimin dhe kontrollin e dokumentacionit institucional, përgatitjen dhe përditësimin e Partner Information Forms (PIF), sigurimin e dokumenteve institucionale, ndjekjen e miratimeve nga Rektori dhe/ose Bordi i Administrimit, procedurat për nënshkrim dhe vulosje, si dhe mbështetjen për aksesin në sistemet elektronike të aplikimit.

Gjatë periudhës së raportimit kjo mbështetje është reflektuar në një numër të konsiderueshëm iniciativash dhe projekt-propozimesh në kuadër të **Horizon Europe, Erasmus+, Interreg, CERV, EIT, Creative Europe** dhe programeve të tjera. Evidenca e projekteve e përditësuar në shtator 2026 përmbante **58 iniciativa/projekt-propozime të evidentuara**, por ky numër

nuk duhet interpretuar si 58 aplikime të dorëzuara, pasi përfshin edhe riaplikime, iniciativa në përgatitje dhe raste për të cilat nuk disponohet konfirmimi përfundimtar i dorëzimit.

Në mënyrë të veçantë, gjatë muajve gusht–shtator është ofruar mbështetje për aplikimet në **Interreg VI-A IPA Greece-Albania 2021-2027**, përfshirë shqyrtimin e kërkesave të thirrjeve, dokumentacionin institucional, koordinimin me njësitë akademike dhe partnerët, si dhe procedurat për aksesin në sistemin e aplikimit. Mbështetja e ofruar gjatë ciklit të aplikimit është reflektuar edhe në rezultatet e vitit 2026, ku një pjesë e projekt-propozimeve kanë kaluar fazat e vlerësimit dhe janë shpallur fituese, ndërsa aplikime të tjera kanë vijuar në faza të mëtejshme vlerësimi ose kanë qenë në pritje të rezultatit në fund të periudhës së raportimit.

TREGUESI	JANAR-SHTATOR 2026
INICIATIVA/PROJEKT-PROPOZIME TË EVIDENTUARA NË DATABAZË	**58**
PROJEKT-PROPOZIME NDËRKOMBËTARE TË SHPALLURA FITUESE DERI NË PERIUDHËN E RAPORTIMIT	**4**
FORMA KRYESORE TË MBËSHTETJES	*Informim, analizë thirrjeje, PIF, dokumentacion institucional, miratime, nënshkrime, partneritete dhe asistencë për aplikim*

Tabela nr. 11. Treguesit e iniciativave dhe projekt-propozimeve ndërkombëtare dhe mbështetja e ofruar nga SKSHP-ja gjatë periudhës janar-shtator 2026

Evidenca e vitit 2026 tregon një intensifikim të aktivitetit të aplikimit dhe një rritje të nevojës për asistencë të specializuar në fazën **pre-award**. Numri i lartë i iniciativave të evidentuara, kompleksiteti i programeve financuese dhe kërkesat për dokumentacion, partneritete dhe miratime institucionale mbështesin nevojën për një administrim më të strukturuar të procesit nga identifikimi i thirrjes deri në dorëzimin dhe ndjekjen e rezultatit të aplikimit.

10. AKTIVITETET KËRKIMORE-SHKENCORE

Gjatë periudhës janar-shtator 2026, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë është zhvilluar një veprimtari e gjerë kërkimore-shkencore, e organizuar nga fakultetet, departamentet, qendrat kërkimore-shkencore dhe strukturat e tjera akademike të Universitetit.

Aktivitetet e realizuara kanë përfshirë konferenca, seminare dhe workshop-e shkencore, leksione të hapura, aktivitete në kuadër të projekteve, prezantime të rezultateve të kërkimit, veprimtari me studentët dhe doktorantët, aktivitete ndërgjegjësuese dhe promovuese, si dhe iniciativa të zhvilluara në bashkëpunim me institucione dhe partnerë të jashtëm.

Gjatë periudhës së raportimit, SKSHP ka vijuar mbledhjen, evidentimin dhe përditësimin e informacionit mbi aktivitetet kërkimore-shkencore të zhvilluara nga njësitë akademike. Informacioni i administruar përfshin, sipas rastit, njësinë organizatore, titullin dhe tipologjinë e aktivitetit, datën e zhvillimit, pjesëmarrësit, bashkëpunëtorët dhe informacionin përkatës mbi realizimin e tij.

Në veprimtarinë e vitit 2026 evidentohet gjithashtu përfshirja e studentëve në aktivitete me karakter kërkimor dhe aplikativ. Ndër aktivitetet e raportuara përfshihen prezantime të ecurisë së punës kërkimore të doktorantëve, prezantime të projekteve studentore, workshop-e tematike në fushën e mjedisit dhe shkencave të aplikuara, si dhe aktivitete të zhvilluara në kuadër të **Javës së Shkencës**.

Administrimi i kësaj evidence shërben jo vetëm për dokumentimin e veprimtarisë shkencore të Universitetit, por edhe për monitorimin e intensitetit dhe shpërndarjes së aktiviteteve ndërmjet njësive akademike, përgatitjen e raportimeve institucionale dhe promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor.

Veprimtaria kërkimore-shkencore e periudhës dëshmon përfshirjen e njësive akademike në forma të ndryshme të komunikimit dhe promovimit të kërkimit. Përmirësimi i mëtejshëm i mënyrës së raportimit dhe standardizimi i të dhënave për çdo aktivitet do të mundësojnë që kjo databazë të përdoret edhe për analiza krahasuese ndërmjet viteve, njësive akademike dhe kategorive të aktiviteteve.

11. DATABAZAT DHE ADMINISTRIMI I INFORMACIONIT KËRKIMOR-SHKENCOR

Gjatë periudhës janar-shtator 2026, SKSHP ka vijuar krijimin, administrimin dhe përditësimin e databazave institucionale që lidhen me kërkimin shkencor, projektet, personelin akademik dhe veprimtaritë përkatëse. Administrimi i të dhënave përbën një funksion të rëndësishëm të Sektorit, pasi siguron informacion të strukturuar për monitorimin, raportimin dhe vendimmarrjen institucionale.

Gjatë vitit 2026 është punuar për administrimin dhe përditësimin e databazave që lidhen me **projektet dhe projekt-propozimet, thirrjet dhe mundësitë e financimit, partnerët, publikimet shkencore, aktivitetet kërkimore-shkencore dhe të dhënat e personelit akademik**.

Në kuadër të përditësimit të informacionit institucional janë administruar gjithashtu evidencat për **titujt akademikë të personelit me kohë të plotë**, databaza e kontakteve të personelit sipas fakulteteve dhe departamenteve, si dhe databaza e **CV-ve dhe profileve akademike**. Për këtë të fundit është punuar edhe për evidentimin e informacionit të nevojshëm për prezantimin institucional të personelit akademik.

Një komponent i veçantë ka qenë administrimi i databazës së **aktiviteteve kërkimore-shkencore të katër fakulteteve**, e cila mbledh në mënyrë të strukturuar informacion mbi veprimtaritë shkencore të zhvilluara gjatë vitit dhe shërben si burim për raportimin institucional dhe publikimin e informacionit.

Gjatë periudhës është vijuar gjithashtu përditësimi i evidencave institucionale për **Doctor Honoris Causa**, duke përfshirë të dhënat historike nga viti 1994 e në vijim, si dhe evidencat për titujt **"Profesor Emeritus", "Mirënjohje e Universitetit" dhe "Nderi i Universitetit"**.

Në fushën e projekteve, administrimi i informacionit është orientuar drejt krijimit të një evidence që mundëson ndjekjen e projektit përgjatë ciklit të tij, nga identifikimi i mundësisë së financimit dhe aplikimi, deri te rezultati, financimi dhe zbatimi. Kjo qasje krijon bazën për ndarjen funksionale të databazave ndërmjet proceseve **pre-award** dhe **post-award**, duke shmangur mbivendosjen e informacionit dhe duke përmirësuar gjurmueshmërinë e çdo aplikimi dhe projekti.

Zgjerimi i databazave gjatë vitit 2026 ka rritur sasinë dhe larminë e informacionit që administrohet nga SKSHP. Për periudhën në vijim, prioritet mbetet standardizimi dhe ndërlidhja e këtyre evidencave, në mënyrë që të mundësohet nxjerrja më e shpejtë e treguesve statistikorë dhe KPI-ve për kërkimin shkencor dhe projektet, si dhe përdorimi i tyre për raportimet periodike dhe planifikimin strategjik të Universitetit.

12. INOVACIONI, PATENTIMI, LICENCIMI DHE TRANSFERIMI I NJOHURIVE

Gjatë periudhës **janar–shtator 2026**, SKSHP ka ndjekur procedura që lidhen me mbrojtjen dhe formalizimin e rezultateve me potencial inovativ, si dhe me proceset institucionale për licencimin dhe akreditimin e kapaciteteve kërkimore të Universitetit.

Një nga proceset e ndjekura lidhet me sistemin **UNVIMAS – University Virtual Management System**, të zhvilluar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë. Gjatë vitit 2026 është vijuar procedura për **regjistrimin e markës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI)**, duke përfshirë përgatitjen dhe plotësimin e dokumentacionit, komunikimin institucional me strukturat përgjegjëse dhe ndjekjen e kërkesave të procedurës.

Në vijim të procesit janë trajtuar edhe elemente që lidhen me dokumentacionin e licencimit, aktin noterial, ndryshimin e emërtimit nga **UVMS në UNVIMAS**, përshtatjen e logos së sistemit në bashkëpunim me strukturën e teknologjisë së informacionit dhe procedurat përkatëse të aplikimit elektronik.

Ky proces përbën një hap në drejtim të **mbrojtjes së pronësisë industriale dhe formalizimit të produkteve të krijuara brenda Universitetit**, duke krijuar një praktikë institucionale që mund të përdoret edhe për rezultate të tjera me potencial për regjistrim, patentim, licencim apo transferim.

Një drejtim tjetër i punës gjatë periudhës ka qenë ndjekja e procedurave për **akreditimin/licencimin e laboratorëve kërkimorë**, me fokus te kapacitetet laboratorike të Qendrës Kërkimore-Shkencore në Shkencat e Aplikuara. Procesi ka përfshirë mbledhjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit, komunikimin me strukturat përkatëse dhe evidentimin e kërkesave që duhet të plotësohen për vijimin e procedurave.

Në këtë kuadër është shqyrtuar edhe mundësia e përfshirjes së kapaciteteve laboratorike të Fakultetit të Shëndetit dhe janë ndjekur kërkesat që lidhen me dokumentacionin dhe kushtet e nevojshme për formalizimin e veprimtarisë laboratorike.

Veprimtaria e vitit 2026 në këtë fushë tregon hapat e parë drejt një qasjeje më të strukturuar për mbrojtjen e rezultateve inovative dhe formalizimin e kapaciteteve kërkimore të UV-së. Megjithatë, në periudhën e raportimit **nuk rezulton ende një patentë e regjistruar apo një proces i përfunduar i transferimit të teknologjisë**, ndaj kjo fushë mbetet një drejtim për zhvillim të mëtejshëm. Prioritet për periudhën në vijim është krijimi i mekanizmave për identifikimin e rezultateve me potencial për pronësi intelektuale, patentim, licencim dhe transferim të njohurive drejt aktorëve ekonomikë dhe institucionalë.

13. Analiza e performancës së SKSHP-së

Analiza e performancës së SKSHP-së për periudhën janar–shtator 2026 mbështetet në tregues të matshëm që lidhen me kërkimin shkencor, projektet, mbështetjen e personelit akademik, integritetin akademik dhe administrimin e proceseve kërkimore.

Të dhënat e mbledhura gjatë periudhës tregojnë një zgjerim të ndjeshëm të volumit të veprimtarisë së Sektorit, veçanërisht në administrimin e projekteve, mbështetjen e aplikimeve, përdorimin e iThenticate, procedurat e mbështetjes financiare dhe administrimin e databazave institucionale.

13.1. Treguesit kryesorë të performancës (KPI)

Në bazë të të dhënave që kemi verifikuar deri në këtë fazë të raportit, tabela e KPI-ve mund të ndërtohet si më poshtë:

FUSHA	TREGUESI	JANAR–SHTATOR 2026
PUBLIKIME	Publikime të indeksuara në Scopus	**11**
PUBLIKIME	Publikime të indeksuara në Web of Science	**3**
PUBLIKIME	Publikime unike Scopus/WoS*	**13**
KËRKIM INSTITUCIONAL	Projekte PKZHUV në zbatim	**26**

FINANCIM INSTITUCIONAL	Fondi PKZHUV	**19,200,000 lekë**
PROJEKTE KOMBËTARE	Projekte AKKSHI në zbatim	**8**
PROJEKTE	Projekte të evidentuara me status "në vazhdim" në databazën e paraqitur	**23**
PROJEKTE/APLIKIME	Iniciativa/projekt-propozime të evidentuara	**58**
MBËSHTETJE FINANCIARE	Procedura për monografi, artikuj dhe aktivitete shkencore	**37**
ZHVILLIM AKADEMIK	Procedura për rimbursimin e fitimit të titullit "Profesor i Asociuar"	**9**
INTEGRITET AKADEMIK	Përdorues të rinj me llogari individuale iThenticate	**72**

Tabela nr. 12. Treguesit kryesorë të kërkimit shkencor, projekteve dhe mbështetjes akademike gjatë periudhës janar-shtator 2026

Treguesit evidentojnë se veprimtaria e SKSHP-së gjatë vitit 2026 nuk kufizohet në një funksion të vetëm administrativ, por përfshin një cikël të gjerë procesesh: nga financimi dhe evidentimi i kërkimit, te mbështetja e aplikimeve, administrimi dhe monitorimi i projekteve, integriteti akademik dhe mbështetja e zhvillimit të personelit akademik. Veçanërisht të rëndësishme janë rritja e fondit institucional për kërkimin, zgjerimi i portofolit të projekteve dhe rritja e aksesit të personelit në instrumentet për garantimin e integritetit akademik.

Nr.	***Treguesi***	***Vlera***
1	Publikime unike të indeksuara në Scopus/WoS	**13**
2	Projekte PKZHUV në zbatim	**26**
3	Fondi PKZHUV	**19,200,000 lekë**
4	Projekte me financim kombëtar në zbatim	**8**
5	Projekte me status "në vazhdim" në databazë	**23**
6	Procedura mbështetjeje financiare	**37**
7	Llogari të reja iThenticate	**72**

Tabela nr. 13. Treguesit kryesorë të kërkimit shkencor dhe projekteve gjatë periudhës janar-shtator 2026

13.3. ANALIZA E TENDENCAVE DHE REZULTATEVE

Analiza e treguesve të periudhës janar–shtator 2026 evidenton një **zgjerim të veprimtarisë së SKSHP-së**, si në mbështetjen e kërkimit shkencor, ashtu edhe në administrimin e projekteve, asistencën për aplikime dhe zhvillimin e mekanizmave institucionalë për integritetin akademik dhe administrimin e informacionit kërkimor.

Një nga tendencat më të dukshme lidhet me **rritjen e mbështetjes institucionale për kërkimin shkencor**. Fondi i parashikuar për PKZHUV është rritur nga **14,000,000 lekë në vitin 2025 në 19,200,000 lekë në vitin 2026**, ose me **37,1%**. Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2026 janë në zbatim **26 projekte PKZHUV**, të shpërndara në njësitë akademike dhe strukturat kërkimore të Universitetit.

Një tendencë tjetër e rëndësishme është **zgjerimi dhe diversifikimi i portofolit të projekteve**. Krahas projekteve të financuara nga UV, Universiteti është përfshirë në projekte të financuara nga AKKSHI dhe në programe ndërkombëtare si Horizon Europe, Erasmus+, Interreg IPA dhe CEEPUS. Veçanërisht domethënës është forcimi i rolit të UV-së nga partner në konsorciume drejt marrjes së roleve drejtuese dhe koordinuese në projekte të caktuara.

Në fazën e aplikimeve evidentohet një **rritje e aktivitetit pre-award**, e reflektuar në numrin e lartë të iniciativave dhe projekt-propozimeve të evidentuara gjatë periudhës. Kjo prirje shoqërohet me rritjen e volumit dhe kompleksitetit të punës për analizën e thirrjeve, identifikimin e partnerëve, përgatitjen e dokumentacionit institucional, koordinimin e miratimeve dhe mbështetjen e aplikantëve.

Në fushën e **integritetit akademik**, krijimi i **72 llogarive të reja individuale në iThenticate** përbën një zhvillim të rëndësishëm. Zgjerimi i aksesit e zhvendos përdorimin e platformës nga një mekanizëm vetëm verifikues drejt një instrumenti që mund të përdoret paraprakisht nga vetë personeli akademik gjatë përgatitjes së produkteve shkencore.

Në të njëjtën kohë, trajtimi i **37 procedurave për mbështetje financiare të botimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore**, si dhe i **9 procedurave për rimbursimin e shpenzimeve të lidhura me fitimin e titullit "Profesor i Asociuar"**, evidenton rritjen e rolit mbështetës dhe verifikues të Sektorit ndaj veprimtarisë dhe zhvillimit akademik të personelit.

Në drejtim të administrimit të informacionit, zgjerimi i databazave për publikimet, projektet, projekt-propozimet, partnerët, thirrjet, aktivitetet kërkimore-shkencore dhe personelin akademik ka krijuar një bazë më të gjerë për raportimin dhe monitorimin institucional. Megjithatë, rritja e volumit të informacionit evidenton njëkohësisht nevojën për **standardizimin dhe integrimin e databazave**, në mënyrë që treguesit statistikorë dhe KPI-të të gjenerohen në mënyrë më të shpejtë dhe të krahasueshme.

Në tërësi, rezultatet e periudhës tregojnë një tendencë drejt **rritjes së aktivitetit kërkimor dhe projektual, diversifikimit të burimeve të financimit, forcimit të ndërkombëtarizimit dhe formalizimit më të mirë të proceseve të administrimit të kërkimit shkencor**. Këto zhvillime krijojnë njëkohësisht kërkesa të reja për kapacitete njerëzore, organizim të brendshëm dhe sisteme më efikase të monitorimit dhe administrimit të informacionit.

14. PROBLEMATIKAT DHE ÇËSHTJET E EVIDENTUARA

Gjatë periudhës janar-shtator 2026, krahas rezultateve të arritura, janë evidentuar disa çështje që ndikojnë në efikasitetin e administrimit të kërkimit shkencor dhe projekteve dhe që kërkojnë adresim në periudhën në vijim.

Një nga çështjet kryesore lidhet me **rritjen e ndjeshme të volumit dhe kompleksitetit të proceseve të projekteve**. Numri i thirrjeve, partneriteteve, projekt-propozimeve dhe projekteve në zbatim kërkon ndjekje të vazhdueshme të afateve, dokumentacionit, miratimeve, kërkesave të programeve financuese dhe komunikimit me partnerët. Kjo e bën të nevojshme një ndarje më të qartë të funksioneve ndërmjet fazës **pre-award** dhe fazës **post-award**.

Një tjetër çështje lidhet me **fragmentarizimin e informacionit në databaza dhe evidenca të ndryshme**. Megjithëse gjatë vitit 2026 është bërë një punë e konsiderueshme për përditësimin e tyre, mungesa e një sistemi të integruar vështirëson nxjerrjen automatike të treguesve, krahasimin ndërmjet periudhave dhe monitorimin e plotë të ciklit të një projekti nga identifikimi i thirrjes deri në përfundimin e tij.

Në fushën e kërkimit shkencor, mbetet e nevojshme **rritja e vazhdueshme e publikimeve të indeksuara në Scopus dhe Web of Science**, si dhe përmirësimi i mekanizmave për evidentimin në kohë reale të rezultateve shkencore të personelit akademik. Në të njëjtën

kohë, kërkohet forcimi i përdorimit të treguesve bibliometrikë për analizën e performancës kërkimore.

Procedurat e rimbursimit kanë evidentuar raste të **dokumentacionit të paplotë ose të paraqitur jo në përputhje të plotë me kërkesat institucionale**, duke krijuar nevojën për komunikim shtesë me aplikantët dhe plotësim të dokumentacionit përpara vijimit të procedurave. Për këtë arsye, nevojitet një informim më i standardizuar paraprak mbi dokumentacionin dhe kriteret për secilën kategori mbështetjeje financiare.

Në fushën e inovacionit dhe transferimit të njohurive, megjithëse janë ndërmarrë hapa për regjistrimin e markës **UNVIMAS** dhe për formalizimin e kapaciteteve laboratorike, mbetet për t'u zhvilluar më tej një mekanizëm institucional për **identifikimin, vlerësimin dhe mbështetjen e rezultateve me potencial për patentim, licencim dhe transferim teknologjie**.

Gjithashtu, rritja e numrit të projekteve dhe aplikimeve evidenton nevojën për **forcimin e kapaciteteve njerëzore të SKSHP-së**, veçanërisht në proceset pre-award, në mënyrë që monitorimi i thirrjeve, zhvillimi i partneriteteve dhe asistenca për aplikime të realizohen paralelisht me administrimin dhe monitorimin e projekteve të financuara.

15. OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET PËR PERIUDHËN NË VIJIM

Në mbështetje të rezultateve të arritura gjatë periudhës janar–shtator 2026, problematikave të evidentuara dhe objektivave të përcaktuara në **Strategjinë e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të UV-së 2026–2030**, veprimtaria e SKSHP-së për periudhën në vijim do të orientohet drejt forcimit të kapaciteteve kërkimore, rritjes së pjesëmarrjes në programe financimi, përmirësimit të administrimit të projekteve dhe konsolidimit të mekanizmave institucionalë për monitorimin e rezultateve të kërkimit.

Një prioritet kryesor do të jetë **rritja e pjesëmarrjes së UV-së në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare**, përmes monitorimit sistematik të thirrjeve, identifikimit të mundësive në përputhje me fushat prioritare të njësive akademike dhe mbështetjes së personelit që nga faza e konceptimit të projektit deri në dorëzimin e aplikimit. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet programeve të Bashkimit Evropian dhe instrumenteve të tjera që mundësojnë financimin e kërkimit, inovacionit, ngritjes së kapaciteteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në këtë drejtim synohet edhe **rritja e numrit të aplikimeve ku UV merr rol drejtues ose koordinues**, duke kapitalizuar përvojën e krijuar nga projektet në të cilat Universiteti tashmë ushtron role të tilla. Paralelisht do të punohet për identifikimin dhe zhvillimin e partneriteteve strategjike me universitete, institucione kërkimore, organizata dhe aktorë të tjerë me interes për zhvillimin e projekteve të përbashkëta.

Një objektiv i rëndësishëm organizativ është **konsolidimi i ndarjes funksionale ndërmjet proceseve pre-award dhe post-award**. Në fazën pre-award fokusi do të jetë monitorimi dhe analiza e thirrjeve, informimi i njësive akademike, zhvillimi i partneriteteve, mbështetja e aplikimeve dhe administrimi i databazës së thirrjeve, partnerëve dhe projekt-aplikimeve. Në fazën post-award fokusi do të jetë administrimi dhe monitorimi i projekteve të financuara, ndjekja e procedurave administrative dhe financiare, raportimi, mbyllja dhe arkivimi i projekteve, si dhe administrimi i databazës së projekteve të fituara dhe në zbatim.

Në fushën e rezultateve shkencore, prioritet mbetet **rritja e publikimeve në revista të indeksuara në Scopus dhe Web of Science**, përmirësimi i evidentimit të tyre dhe zhvillimi i analizave bibliometrike që mundësojnë monitorimin e performancës sipas njësive akademike, fushave të kërkimit dhe periudhave raportuese.

Do të vijojë gjithashtu puna për **forcimin e integritetit akademik dhe etikës në kërkim**, përmes përdorimit të iThenticate, mbështetjes së personelit akademik në përdorimin korrekt të platformës dhe vijimit të mbështetjes administrative për veprimtarinë e Komitetit të Etikës në Kërkim.

Një tjetër prioritet është **standardizimi dhe integrimi i databazave të administruara nga SKSHP**, me qëllim përmirësimin e cilësisë së të dhënave, shmangien e dublimeve dhe mundësimin e gjenerimit të treguesve statistikorë dhe KPI-ve për raportimet periodike dhe vlerësimin e performancës institucionale.

Në fushën e inovacionit synohet vijimi i procedurave të nisura për **mbrojtjen e pronësisë intelektuale, formalizimin e kapaciteteve laboratorike dhe identifikimin e rezultateve kërkimore me potencial për patentim, licencim dhe transferim të njohurive**, duke forcuar njëkohësisht lidhjen ndërmjet kërkimit akademik dhe nevojave të ekonomisë e të territorit.

NR.	PRIORITETI	REZULTATI I SYNUAR
1	Rritja e pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare	Më shumë aplikime cilësore dhe projekte të financuara
2	Rritja e rolit të UV-së si koordinator/lider	Forcim i pozicionit të UV-së në konsorciume
3	Zhvillimi i partneriteteve strategjike	Zgjerim dhe konsolidim i rrjetit të partnerëve
4	Konsolidimi i proceseve pre-award/post-award	Ndarje më e qartë e përgjegjësive dhe përmirësim i ciklit të menaxhimit të projekteve
5	Rritja dhe monitorimi i publikimeve Scopus/WoS	Përmirësim i performancës dhe dukshmërisë shkencore
6	Standardizimi dhe integrimi i databazave	Informacion më i saktë dhe gjenerim më efikas i KPI-ve
7	Forcimi i integritetit dhe etikës në kërkim	Përdorim më i gjerë dhe efektiv i mekanizmave institucionalë
8	Zhvillimi i inovacionit dhe pronësisë intelektuale	Identifikim dhe mbështetje e rezultateve me potencial për patentim/licencim
9	Forcimi i kapaciteteve të SKSHP-së	Mbështetje më e specializuar për kërkimin dhe projektet

Tabela nr. 14. Prioritetet kryesore të SKSHP-së për periudhën në vijim

Prioritetet e përcaktuara synojnë që rritja e volumit të veprimtarisë kërkimore dhe projektuale të shoqërohet me një përmirësim të njëkohshëm të cilësisë së proceseve të mbështetjes, monitorimit dhe raportimit. Zbatimi i tyre do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve institucionale të UV-së dhe në realizimin gradual të objektivave të Strategjisë së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2026-2030**.**

16. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Analiza e veprimtarisë së SKSHP-së për periudhën janar–shtator 2026 evidenton një zgjerim të aktivitetit kërkimor dhe projektual të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, të shoqëruar me rritjen e mbështetjes financiare institucionale për kërkimin, zgjerimin e portofolit të projekteve, intensifikimin e aplikimeve për financime dhe konsolidimin e mekanizmave për integritetin akademik dhe administrimin e informacionit kërkimor.

Rritja e fondit PKZHUV, numri i projekteve në zbatim, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe marrja e roleve koordinuese nga UV në projekte të caktuara përbëjnë tregues pozitivë të zhvillimit të kapaciteteve institucionale në fushën e kërkimit dhe projekteve.

Paralelisht, zgjerimi i aksesit në iThenticate, funksionimi i mekanizmave të etikës në kërkim, mbështetja e programit të doktoratës, administrimi i procedurave të mbështetjes financiare dhe përditësimi i databazave kanë kontribuar në forcimin e infrastrukturës institucionale që mbështet cilësinë dhe integritetin e kërkimit shkencor.

Nga analiza rezulton gjithashtu se rritja e volumit të veprimtarisë sjell nevojën për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe organizative të SKSHP-së. Në veçanti, ndarja më e qartë e funksioneve pre-award dhe post-award, standardizimi i databazave dhe procedurave, si dhe përdorimi sistematik i treguesve të performancës do të mundësojnë një administrim më efikas të ciklit të kërkimit dhe projekteve.

Në këtë kuadër, rekomandohet vijimi i mbështetjes financiare për kërkimin shkencor; forcimi i mekanizmave për rritjen e publikimeve të indeksuara në Scopus dhe Web of Science; zhvillimi i partneriteteve strategjike dhe aplikimeve ku UV merr rol drejtues; konsolidimi i proceseve pre-award dhe post-award; integrimi i databazave dhe përdorimi i KPI-ve në raportimin periodik; forcimi i mekanizmave të integritetit dhe etikës; si dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve për inovacion, pronësi intelektuale dhe transferim të njohurive.

Në përfundim, rezultatet e periudhës janar-shtator 2026 tregojnë se SKSHP ka një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në koordinimin, mbështetjen dhe monitorimin e ekosistemit të kërkimit shkencor dhe projekteve të Universitetit. Konsolidimi i proceseve të nisura dhe adresimi i problematikave të evidentuara do të jenë përcaktues për rritjen e mëtejshme të performancës kërkimore, sigurimin e financimeve konkurruese dhe forcimin e pozicionit të Universitetit në hapësirën kombëtare dhe evropiane të kërkimit dhe inovacionit.

17. LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesa	Emërtimi i plotë
UV	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
SKSHP	Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve
SA	Senati Akademik
BA	Bordi i Administrimit
FE	Fakulteti i Ekonomisë
FSH	Fakulteti i Shëndetit
FSHH	Fakulteti i Shkencave Humane
FSHTN	Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore
QZHR	Qendra e Zhvillimit Rajonal
QKSH	Qendra Kërkimore-Shkencore
PKZHUV	Projekte të Kërkim-Zhvillimit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
READ	Research Expertise from the Academic Diaspora
KEK	Komiteti i Etikës në Kërkim
DPPI	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
PIF	Partner Information Form
KPI	Key Performance Indicator / Tregues Kryesor i Performancës
WoS	Web of Science
CBHE	Capacity Building in Higher Education
CEEPUS	Central European Exchange Program for University Studies
CERV	Citizens, Equality, Rights and Values
EIT	European Institute of Innovation and Technology
IPA	Instrument for Pre-Accession Assistance
CSA	Coordination and Support Action
UNVIMAS	University Virtual Management System

Tabela nr. 15. Lista e shkurtesave dhe emërtimet e tyre të plota

SHTOJCA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË
DREJTORIA E KËRKIM – ZHVILLIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

ASISTIMI I PROCEDURAVE TË FITIMIT TË TITUJVE AKADEMIKË NË UV

Nr	Titulli	Organizatori	Data	Vendi	Linku i publikimit	Përshkrimi i punës
1	Akordimi i titullit të nderit "Doctor Honoris Causa" - Z.Andreas Schieder	UV	30.01.2026	Salla "Ali Asllani"	https://univlora.edu.al/njoftime/uv-nderon-andreas-schieder-me-titullin-doctor-honoris-causa	-Ndjekjen e procedurave për zhvillimin e ceremonisë; -Hartimi i certifikata në shqip dhe anglisht e titullit të nderit "Doctor Honoris Causa" -Njoftimi, koordinimi i pjesëmarrësve në ceremoni. - Prezantimi i ceremonisë (Arta) - Përgatija e materialit për publilkim.

MBËSHTETJE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE KËRKIMORE – SHKENCORE:

Nr	Titullli	Organizatori	Data	Vendi	Linku i publikimit	Përshkrimi i punës
1	Mbështetje për organizimin e konferencës shkencore "Vlora Mini Course on Data Sciences and AI"	UV- Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore	15-19.06.2025	Salla "Ali Asllani"	https://www.facebook.com/events/universiteti-i-vlor%C3%ABs-ismail-qemali/june-15-june-19-workshop-on-foundations-of-ai/1230894878931098/	-Mbështetje në organizimin e aktivitetit. -Pergatitja e materialeve te nevojshme logjistike. -Mbikqyrjen e aktivitetit gjatë ceremonisë dhe mbarëfunksionimi të tij.

					?locale=mk_MK	-Pergatitja e materialit per publikim.
2	Asistencë për organizimin e konferencës së 2-rë ndërkombëtare me temë " 2nd Smart City/Smart Port Conference in Vlore "	UV- Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore	04.03.2026	Salla "Ali Asllani"	https://www.instagram.com/reel/DVdQgWyjdnz/	-Mbështetje në organizimin e aktivitetit. -Pergatitja e materialeve te nevojshme logjistike. -Mbështetje në rregjistrim -Mbikqyrjen e aktivitetit gjatë ceremonisë dhe mbarëfunksionimi të tij. -Pergatitja e materialit per publikim
3	Asistencë për organizimin e konferencës "Konference Studentore në datën 10 Maj"	UV- Fakulteti i Shkencave Humane	10.05.2026	FSHH		-Mbështetje në organizimin e aktivitetit. -Pergatitja e materialeve te nevojshme logjistike. -Mbikqyrjen e aktivitetit gjatë ceremonisë dhe mbarëfunksionimi të tij. -Pergatitja e materialit per publikim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË
DREJTORIA E KËRKIM – ZHVILLIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME TË TRETËT
SEKTORI I KËRKIMT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

HARTIMI I DATABAZAVE

Nr	Databaza	Specifikim
1	Përditësimi i databazës me Titujt të dhënë "Doctor Honoris Causa" nga viti 1994 e deri më tani	Gjatë vitit 2025 janë dorëzuar dy tituj "Doctor Honoris Causa" - Z.Andreas Schieder; Z. Arjan Vasjari
2	Përditësimi i databazës me Titujt të dhënë "Professor Emeritus"	
3	Përditësimi i databazës me Titujt të dhënë "Mirënjohje e Universitetit"	
4	Përditësimi i databazës me Titujt të dhënë "Nderi i Universitetit"	
5	Përditësimi i databazës me Titujt akademik të personelit akademik	Përditësimi i 200 personelit akademik me kohë të plotë.
6	Krijimi i databases se kontakteve per stafin akademik te UV-se dhe përditësimi i kontakte të ndara sipas fakulteteve/departamenteve në e-mailin zyrtar të sektorit: projects.reseach@univlora.edu.al	Kjo databazë ndihmon në përcimin më të lehtë të e-maileve në grup të personelit akademik.
7	Krijimi i databases se aktiviteteve kerkimore - shkencore per katër fakultetet.	Përmbledhja e gjithë aktiviteteve kërkimore shkencore të planifikuara për t'u realizuar nga katër fakultetet e UV-së.
8	Krijimi i databases me CV-të e gjithë personelit akademik të UV-së (biografi të shkurtër në shqip- anglisht)	Komunikime te vazhdueshme me personelin akademik. Përshtatja e biografive të shkurtra sipas modelit standard te përzgjedhur. Përgatitja e biografive të përmbledhura sipas fakuteteve/departamentave gati për publikim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

